



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

NR. 1041 (58339-01501-61-2016) AKTI
Dt. 02.11.2016 Regj.

NR. 564 (61-2017-4424) VENDIMI
Dt. 04.10.2017 Vendimi

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë prej:

GJYQTAR: SKËNDER HALUCI
GJYQTARE: ATALANTA ZEQRIRAJ
GJYQTAR: LAURENT FUÇIA

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Eglantina Murati**, sot më dt. 04.10.2017, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, me gjykim të shkurtuar, çështjen penale me nr. **1041 (58339-01501-61-16)** Akti, që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përfaqësuar nga prokurori **Arjan Xhaferraj**

I PANDEHUR: **Petro Beja**, i biri i Thoma-it dhe i Fotina-s, i lindur më dt. 01.03.1937, lindur në Dhermi, Vlorë dhe banues në Vlorë, me gjendje civile "i martuar", me shtetësi Shqiptare, me gjendje gjyqësore "i padënuar", i hetuar në gjendje të lirë, ne mungese, i mbrojtur në gjykim nga **Av. Blerim Hallulli**, i zgjedhur prej të pandehurit, me prokurën e posaçme Nr. 502 Rep, Nr. 476 Kol., dt. 30.04.2017.

Theodhori Beja, i biri i Thoma-it dhe i Fotina-s, i lindur më dt. 01.07.1941, lindur në Dhermi, Vlorë dhe banues në Vlorë, L.: "28 Nëntori", Rr.: "Mulla Xhaferi", Pallati 1084, H. 1, kati 4, me gjendje civile "i martuar", me shtetësi Shqiptare, me gjendje gjyqësore "i padënuar", i hetuar në gjendje të lirë, i mbrojtur në gjykim nga **Av. Halit Demaj** i zgjedhur prej të pandehurit.

Thoma Beja, i biri i Petro-s dhe i Zaharulla-s, i lindur më dt. 18.08.1963, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, L.: "Pavarësia", rr.: "Jani Kosta", pallati pranë Piceri Boklyn,

hyrja 1, kati 8. me gjendje civile "i martuar", me shtetësi Shqiptare, me gjendje gjyqësore "i padënuar", i hetuar në gjendje të lirë, ne mungese, i mbrojtur në gjykim nga **Av. Edmond Dema**, i zgjedhur prej të pandehurit, me prokurën e posaçme Nr. 503 Rep., Nr. 477 Kol., dt. 30.04.2017.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287, gërma "a", "b" dhe "c" i K.Penal.

Gjykata në përfundim të gjykimit të çështjes, pasi dëgjoji palët, të cilët përfundimisht kërkuan:

- Prokurori:** "1 -Deklarimin fajtor të të pandehurit Petro Beja, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.
2. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen me 1/3 e dënimit.
3. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 5-ujetësh.
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit Theodhori Beja, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.
5. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen me 1/3 e dënimit.
6. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 5-ujetësh.
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit Thoma Beja, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.
8. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen me 1/3 e dënimit.
9. Të deklarohet falsiteti i dokumentacionit të sekuestruar si provë materiale me procesverbalët e datës 12.07.2016; 15.09.2016, 19.09.2016 pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe më pas të asgjësohet ky dokumentacion.
10. Pasuria e paluajtshme e vendosur nën masën e sigurimit pasuror "sekuestro preventive" me vendimin me nr. 249 datë 15.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e llojit "Kullotë", "Pyll", me sipërfaqe totale prej 54.6 ha, e ndodhur në fshatin Gjilekë-Dhermi, regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me numrat hipotekorë 440, 441, 442 dhe 443 datë 20.12.2006 dhe nr. 207 datë 31.07.2008, që kanë pasur si titull pronësie vendimet me nr. 133, nr. 134, nr. 135, nr. 136, datë 29.05.2006 dhe nr. 175 datë 21.06.2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarkut Vlorë dhe vendimit me nr.1333 datë 19.05.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të konfiskohet dhe të kalojë në favor të shtetit.
11. Shpenzimet proceduriale të fazës së hetimit dhe ato të gjykimit t'i ngarkohen këtij të pandehuri.";

I pandehuri Petro Beja dhe mbrojtësi i tij av. Blerim Hallulli: "Bazuar në nenin 388/1/b të japë për të pandehurin Petro Beja vendim pafajësie pasi fakti nuk përbën veprë penale";

I pandehuri Theodhori Beja dhe mbrojtësi i tij av. Halit Demaj: "Akuza nuk qëndron dhe nuk provohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe pikërisht mbi bazën e të gjitha argumentave dhe provave të përmbledhura në diskutim kërkojmë deklarin e pafajshëm të të pandehurit Theodhori Beja."

I pandehuri Thoma Beja dhe mbrojtësi i tij av. Edmond Dema: "Vendim pafajësie për këtë të pandehur bazuar në nenin 388/1/b të K.Pr.Penale, pasi fakti nuk përbën veprë penale."

dhe pasi shqyrtoi në tërësi materialet e fashikullit të gjykimit;

VËREN:

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është sjellë për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurve Petro Beja, Theodhori Beja dhe Thoma Beja, akuzuar për kryerjen e veprës penale të Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287, gërma "a", "b" dhe "c" i K.Penal.

I. Rrethanat e faktit penal.

ATP Tiranë, mbi bazën e rekomandimeve të Njesisë Task - Forcë për Verifikimin e Ligjshmërisë dhe Mënyrës së Tjetërsimit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, pranë Kryeministrit, të përcjella me shkresën nr. 5146 prot., dt. 28.10.2015, si dhe verifikimeve të kryera pranë arkivit të saj, ka kallzuar pranë organit të akuzës me shkresën nr. 3628/2 prot., dt. 26.11.2015, se vendimet me nr. 133, nr. 134, nr. 135, nr.136, të datës 29.05.2006 dhe ai me nr. 175, dt. 21.06.2006, të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, si dhe Vendimi nr. 1333, dt. 19.05.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë me përmbajtje të falsifikuar.

Me vendimin nr. 133, dt. 29.05.2006, të K.V.K.K.P. Vlorë u është njohur subjekteve Thoma Petro Beja dhe Fotina Zaho Beja e drejta e pronësisë për një sipërfaqe toke e llojit "pyll" dhe "kullotë" prej 15.3 Ha në vendin e quajtur "Shën Koll", fshati Gjilekë, Vlorë. Nga kjo sipërfaqe u është kthyer në këtë vend sipërfaqja 0.94 Ha dhe u është njohur e drejta e kompesimit për pjesën tjetër. Me vendimin nr. 134, dt. 29.05.2006, të K.V.K.K.P. Vlorë, u është njohur dhe kthyer subjekteve Thoma Petro Beja dhe Fotina Zaho Beja sipërfaqja e tokës "pyll e kullotë" prej 2 HA në vendin e quajtur "Njasha", fshati Gjilekë, Vlorë. Me vendimin nr. 135, dt. 29.05.2006 të K.V.K.K.P. Vlorë, u është njohur dhe kthyer subjekteve Thoma Petro Beja dhe Fotina Zaho Beja sipërfaqja e tokës "pyll e kullotë" prej 2 HA në vendin e quajtur "Zhuri" Gjilekë, Vlorë. Me vendimin nr. 136, dt. 29.05.2006 të K.V.K.K.P. Vlorë, nuk u është njohur subjekteve Thoma Petro Beja dhe Fotina Zaho Beja e drejta e pronësisë për sipërfaqjen e tokës "pyll e kullote" prej 2 HA në vendin e quajtur "Gerlak", Gjilekë, Vlorë.

Me vendimin nr. 175, dt. 21.06.2006 të K.V.K.K.P. Vlorë, u është njohur subjekteve Thoma Petro Beja dhe Fotina Zaho Beja e drejta e pronësisë për një sipërfaqe toke "pyll e kullotë" prej 33.3 HA në vendin e quajtur "Dhjaçori" Palasë, Vlorë. Nga kjo sipërfaqe u është kthyer në këtë vend sipërfaqja 2.3 Ha dhe u është njohur e drejta e kompesimit për pjesën tjetër.

Më dt. 20.12.2006, vendimet nr. 133, nr. 134 dhe nr. 135, dt. 29.05.2006 dhe vendimi nr. 175, dt. 21.06.2006, të K.V.K.K.P Vlorë, janë regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë me numrat respektivë hipotekorë 440, 441, 442 dhe 443, në emër të trashëgimtarve të shtetasve Thoma Petro Beja dhe Fotina Zaho Beja, përkatësisht shtetasit Milo Beja me 1/8 pjesë, shtetasit Petro Beja me 7/16 pjesë dhe shtetasit Theodhori Beja me 7/16 pjesë, për sipërfaqen totale 7.24 HA.

Në vijim, pasuria 440 është transkriptuar në pasuritë 138 - 139, datë 23.04.2008. Pasuria nënë 138, dt. 23.05.2008, është pjestuar me vendim gjykate nr. 206 dt. 29.01.2008 dhe pjesa e sipërfaqes prej 4700 m² është regjistruar në emër të shtetasit Theodhori Beja. Kjo pasuri është shitur nga shtetasi Theodhori Beja me kontratën e shitblerjes me nr. 100 Regj., nr. 38 Kol., dt. 19.02.2015, kundrejt çmimit 2.800.000 lekë, për blerësit Erzen Begaj dhe Renato Begaj, të cilët e kanë regjistruar pranë Z.V.R.P.P. Vlorë me nr. 339, dt. 03.06.2015.

Pasuria nr. 139, dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206. dt. 29.01.2008 dhe pjesa e sipërfaqes prej 4700 m², është regjistruar në emër të shtetasit Petro Beja. Këtë pasuri, shtetasi Petro Beja, në prani të bashkëshortes Zaharulla Beja dhe të birit Thoma Beja, me kontratën e shitblerjes nr. 119 regj. nr. 44 kol, dt. 24.02.2015, e ka shitur tek shtetasit Isuf Begaj, Mitat Begaj, Ridvan Begaj dhe Saimir Begaj, kundrejt çmimit prej 2.800.000 lekë dhe çmimit përfundimtar 10.000.000 lekë.

Kjo kontratë është regjistruar në emër të këtyre katër pronarve të rinj pranë Z.V.R.P.P. Vlorë me nr. 340. dt. 03.06.2015.

Pasuria 441 është inskriptuar në pasurinë nr. 12, dt. 10.04.2007 dhe transkriptuar më pas në pasuritë nr. 142 - 144, dt. 23.05.2008.

Pasuria 142, dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206. dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 8975 m² është regjistruar në emër të shtetasit Theodhori Beja. Kjo pasuri është inskriptuar dhe aktualisht është vendosur sekuestro konstervative mbi të.

Pasuria 143. dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206 dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 8975 m² është regjistruar në emër të shtetasit Petro Beja. Kjo pasuri është inskriptuar dhe aktualisht është vendosur sekuestro konstervative.

Pasuria 144, dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206 dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 2050 m², është regjistruar në emër të shtetasit Milo Beja. Kjo pasuri është inskriptuar dhe aktualisht është vendosur sekuestro konstervative.

Pasuria nënë 442 është transkriptuar në pasuritë 145 - 147, dt. 23.05.2008.

Pasuria 145, dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206, dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 6500 m² është regjistruar në emër të shtetasit Theodhori Beja. Kjo pasuri është inskriptuar dhe aktualisht është vendosur sekuestro konservative. Pasuria nr. 146, dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206, dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 6500 m², është regjistruar në emër të shtetasit Petro Beja. Kjo pasuri me kërkesë/aplikimin datë 15.01.2014 të shtetasit Thoma Beja është ndarë dhe transkriptuar në pasuritë 13 - 14, viti 2014. Pasuria nr. 13, dt. 20.01.2014, me sipërfaqe 500 m², me kontratën e shitjes nr. 504 Rep, nr. 212/1 Kol., dt. 12.02.2014, të lidhur nga shtetasi Petro Beja, i përfaqësuar me prokurën nr. 2713 Rep., nr. 1654 Kol., dt. 14.12.2008, nga i biri Thoma Beja dhe shtetasi Shkëlqim Duka, i është shitur këtij të fundit. Më pas kjo pasuri është regjistruar në nenin 109 dt. 20.03.2014 në emër të shtetasit Shkëlqim Duka.

Pasuria 14, dt. 20.01.2014, me sipërfaqe 6000 m², me kërkesë dt. 02.10.2014 të shtetasit Thoma Beja është ndarë dhe transkriptuar në pasuritë 49 e 50, dt. 12.02.2014. Ku, pasuria 49 me sipërfaqe 5500 m² dhe pasuria 50 me sipërfaqe 500 m². Pasuria 50, me sipërfaqe 500 m², me kontratën e shitjes nr. 504 rep, nr. 212/1 kol., dt.12.02.2014 është shitur nga shtetasi Thoma Beja për shtetasin Shkëlqim Duka. Më pas është regjistruar pranë Z.V.R.P.P. Vlorë në emër të këtij të fundit me nr. 109, dt. 20.03.2014.

Pasuria nr. 147, dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206, dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 7000 m² është regjistruar në emër të shtetasit Milo Beja. Kjo pasuri aktualisht është nën sekuestro konservative. Pasuria nr. 443 është transkriptuar në pasuritë 140 - 141, dt.23.04.2008. Pasuria nr. 140, dt. 23.05.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206, dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 11500 m² është regjistruar në emër të shtetasit Theodhori Beja. Për këtë pasuri, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme aktualisht është vendosur sekuestro konservative. Pasuria 141, dt. 23.04.2008 është pjestuar me vendim gjykate nr. 206, dt. 29.01.2008 dhe pjesa prej 11500 m² është regjistruar në emër të shtetasit Petro Beja. Kjo pasuri është inskriptuar dhe aktualisht sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme është vendosur sekuestro konservative.

Gjithashtu, rezultoi se, të tre Vendimet, e konkretisht, vendimi nr. 133, dt. 29.05.2006; vendimi nr. 136, dt. 29.05.2006 dhe vendimi nr. 175, dt. 21.06.2006, të K.V.K.K.P. Vlorë, janë ankimuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë nga trashëgimtarët e shtetasve Thoma Beja dhe Fotina Beja, të përfaqësuar në gjykim nga shtetasi Theodhori Beja. Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 1333, dt. 19.05.2008, ka vendosur ndryshimin e tre vendimeve të mësipërme duke u kthyer trashëgimtarëve të shtetasve Thoma Beja dhe Fotina Beja edhe sipërfaqen prej 47,36 Ha pyll e kullotë që u ishte njohur me këto vendime por nuk u ishte kthyer. Ky vendim gjyqësor, me kërkesë/aplikimin dt. 31.07.2008 të shtetasit Theodhori Beja është regjistruar pranë Z.V.R.P.P. Vlorë me numër hipotekor 207, datë 31.07.2008, me sipërfaqe totale 47.36 Ha "pyll dhe kullotë", në emër të shtetasve Milo, Theodhori, Petro Beja. etj. Pasuria me numër hipotekor 207/2008, mbi bazën e

kërkesë/aplikimit të shtetasit Thoma Beja, i cili ka depozituar raportin e vlerësimit të pronës dhe disa deklarata noteriale për heqjen dorë nga pasuria të disa bashkëpronarëve, është transkriptuar në pasurin 625 datë 08.12.2009, në emër të shtetasve/pronarëve Milo Beja, Petro Beja e Theodhori Beja. Kjo pasuri mbi bazën e kërkesës së datës 16.12.2009 të shtetasit Thoma Beja për pjestim pasurie sipas kontratës së pjestimit vullnetar datë 15.12.2009 të tre pronarëve Milo, Theodhori dhe Petro Beja, është transkriptuar në nr. 676 (20)1; 677 (21); 678(22); 679 (23)4 ; 680 - 682 (24 - 256) dhe nr. 197. dt. 12.01.2010. Me kërkesë të shtetasit Petro Beja datë 15.09.2011, pasuria me nr. 21 (677)/2010, me sipërfaqe totale 14.37 Ha, në emër të shtetasit Petro Beja, është pjestuar dhe transkriptuar në pasuritë me nr. 823 e 824, datë 21.09.2011 dhe nr. 837, date 22.09.2011.

Pasuria nr. 823 është inskriptuar në nenin 37 datë 08.04.2012, duke u vendosur sekuestro konservative. Më pas është liruar nga inskriptimi dhe është transkriptuar në nenet 241 e 242 sipas kërkesë/aplikimit datë 07.07.2016 të shtetasit Thoma Beja. Pasuria nr. 824 mbi bazën e kërkesë/aplikimit datë 07.07.2016 për pjestim pasurie të shtetasit Thoma Beja është transkriptuar në nr. 239 - 240, datë 07.07.2016. Pasuria nr. 837 me sipërfaqe 1450 HA, në emër të shtetasit Petro Beja, me kontratën e shitjes nr. 112 rep. nr. 46 kol date 25.02.2015, të lidhur nga shtetasit Petro Beja, Thoma Beja dhe Zahrulla Beja me shtetasen Shpresa Begaj, i është shitur kësaj të fundit kundrejt çmimit 1,200.000 lekë. Më pas kjo pasuri është regjistruar pranë Z.V.R.P.P. Vlorë në 341, datë 03.06.2015, në emër të shtetasës Shpresa Bega.

Gjithashtu rezultoi se me kontratën e shitjes nr. 1300 rep., nr. 702/3 kol., datë 07.07.2016 të lidhur mes palës shitëse Petro Beja, përfaqësuar nga shtetasi Thoma Beja dhe palës blerëse Dhimitraq Gjini, është shitur pasuria 240, dt. 16.07.2016, me sipërfaqe prej 10555 m2, kundrejt çmimit prej 247.000 euro. Kjo kontratë është administruar nga Policia Gjyqesore prej shtetasit Thoma Beja, por nuk është e regjistruar në regjistrat publikë të Z.V.R.P.P. Vlorë.

Po kështu, rezultoi e provuar se pas regjistrimit në vitet 2006 - 2008 pranë Z.V.R.P.P. Vlorë të pasurisë së paluajtshme "pyll e kullotë" me sipërfaqe totale prej prej 54.6 (pesëdhjetë e katër presje gjashtë) Ha në emër të shtetasve Petro, Milo dhe Theodhori Beja, sipas katër Vendimeve nr. 133, nr. 134, nr. 135, dt. 29.05.2006 dhe nr. 175, dt. 21.06.2006, të K.V.K.K.P. Vlorë, si dhe Vendimit nr. 1333, dt. 19.05.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, nga këta shtetas (Theodhori Beja, Petro Beja dhe Thoma Beja) në vijim janë kryer disa transaksione, si pjestim pasurie dhe shitje pasurie për persona të tjerë, të kryera këto shitje në vitet 2014 - 2016. Konkretisht:

Me nr. hipotekor 109, dt. 20.03.2015 është regjistruar kontrata e shitjes Nr. 504 Rep., Nr. 212/1 Kol., dt. 12.02.2014, për sipërfaqen 1000 m2 të ndodhur në Dhermi, Zona Kadastrale 1481, me shitës shtetasin Petro Beja, i përfaqësuar me prokurën Nr. 2713 Rep., Nr. 1654 Kol., dt. 14.12.2008, nga i biri Thoma Bejo dhe blerës shtetasin Shkëlqim Duka.

Me kontratën e shitjes Nr. 1300 Rep., Nr. 702/3 Kol., dt. 07.07.2016, është shitur nga shtetasi Petro Beja përfaqësuar me prokurën nr. 2713 Rep., Nr. 1654 Kol., dt. 14.12.2008, nga i biri Thoma Bejo për blerësin Dhimitraq Gjini,

pasuria nr. 240, dt.16.07.2016, me sipërfaqe prej 10555 m2 e ndodhur në vendin e quajtur Shënkollë - Dhrale, Palasë - Dhermi, zona kadastrale 1481 - 1739, kundrejt çmimit 247.000 euro.

Me sip. 7.18 Ha në emër të shtetasit Theodhori Beja, me sip. 5.92 Ha në emër të shtetasit Milo Beja 5/10, me nr. hipotekor 340, datë 03.06.2015 është regjistruar kontrata e shitjes Nr. 119/44 Kol., dt. 24.02.2015, për sipërfaqen 4700 m2, ndodhur në Dhermi, Zona Kadastrale 1739, me shitës shtetasin Petro Beja, në prani të bashkëshortes Zaharulla Beja dhe të birit Thoma Beja, dhe blerës shtetasit Isuf Begaj, Mitat Begaj, Ridvan Begaj dhe Saimir Begaj.

Me nr. hipotekor 341, datë 03.06.2015 është regjistruar kontrata e shitjes nr. 122/46 kol, datë 25.02.2015 për sipërfaqen 1450 m2, ndodhur në Gjilek, Zona Kadastrale 1739, me shitës shtetasit Petro Beja, Thoma Beja dhe Zaharulla Beja dhe blerës shtetasin Shpresa Begaj.

Me nr. hipotekor 339, datë 03.06.2015 është regjistruar kontrata e shitjes nr. 100/38, datë 19.02.2015, për sipërfaqen 4700 m2, ndodhur në Gjilek - Himarë, Zona Kadastrale 1739, me shitës shtetasin Theodhori Beja dhe blerës shtetasit Erzen Begaj dhe Renato Begaj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit/akteve të dosjeve mbi bazën e të cilave janë marrë Vendimet nr. 133, nr. 134, nr. 135, nr. 136, datë 29.05.2006, nr. 175 date 21.06.2006, të K.V.K.K.P Vlorë si dhe Vendimi nr. 1333 datë 19.05.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, që përbëjnë titullin e pronësisë së trashëgimtarëve të shtetasve Thoma Beja dhe Fotina Beja, ka rezultuar se këto vendime janë marrë mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara të përdorura nga shtetasi Petro Beja (trashëgimtari) gjatë vërtetimit të faktit juridik të pronësisë.

Sipas vendimit nr. 577, datë 09.04.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për lëshimin e këtyre titujve të pronësisë është përdorur si dokument ligjor kryesor/thelbesor Vendimi nr. 13, datë 31.10.2003 i Këshillit Bashkiak Himarë, me të cilin "vërtetohet pronësia e shtetasit Petro Beja mbi sipërfaqen totale 54.6 Ha "pyll e kullotë" në Dhermi - Gjilekë", si dhe Vendimi nr. 577 datë 09.04.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë që është rrjedhim i këtij dokumenti.

Në bazë të VKM Nr. 560, dt. 16.10.1995 "Për masat për zbatimin e ligjit nr. 7699. dt. 21.04.1993 "Për kompesimin në vlerë të ish - pronarëve të tokës bujqësore", pika 7, parashikohet se kur zyrat e hipotekës dhe kadastrës nuk disponojnë të dhëna për të lëshuar vërtetim zyrtar pronësie sipas regjistrave përpara reformës agrare, vërtetimi i pronësisë do të bëhet nëpërmjet vendimit të këshillit të komunës. Lidhur me ekzistencën e të dhënave të vjetra pronësore të shtetasve Petro Beja, Thoma Beja dhe Fotina Beja janë kryer verifikimet pranë Arkivit Qendror Shtetëror, Z.V.R.P.P. Vlorë dhe Këshillit të Qarkut Vlorë, por nuk kanë rezultuar të dhëna pronësore të para reformës agrare për pasurinë që u është kthyer dhe që kanë regjistruar pranë Z.V.R.P.P. Vlorë. Me shkresën nr. 1046/7, datë 19.03.2014 të Arkivit Qendror të Shtetit është informuar se nuk ka të dhëna që vërtetojnë pronësinë e shtetasit Petro Beja mbi pasuritë e kthyera me vendimet e K.V.K.K.P. Vlorë dhe vendimin e Gjykatës.

Me shkresën nr. 3325, dt. 22.04.2015 të Z.V.R.P.P. Vlorë, është informuar se pranë kësaj zyre nuk figurojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të shtetasve Thoma Petro Beja dhe Fotina Zaho Beja.

Nga verifikimet e kryera pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, prej institucionit të Task - Forcë, pranë Kryeministrit, ka rezultuar se sipas regjistrimeve të Reformës Agrare të viteve 1950 - 1952, në emër të shtetasve Thoma Petro Beja dhe Fotina Bejo figuron e regjistruar listpronësia tokësore me nr. 367 dhe skica përkatëse, për fshatin Dhermi, Himarë. Sipas kësaj liste, në emër të shtetasit Thoma Beja është regjistruar një pasuri "kullotë", në vendin e quajtur "Gerlake", me sipërfaqe prej 11600 m², por jo në vendet që është përcaktuar në vendimin e falsifikuar të Këshillit Bashkiak Himarë. Gjithashtu, në emër të shtetasit Thoma Beja janë regjistruar edhe disa sipërfaqe të vogla "ara, pemishte dhe ullishte", në vende të ndryshme, me një sipërfaqe totale prej 6014 m²., por në asnjë rast nuk figuron pronësia e tij për një sipërfaqe prej 54.6 HA.

Rezultoi i provuar nga provat e administruara në gjykim, me procedure e gjykimit të shkurtuar, se, falsiteti i "Vendimit nr. 13, datë 31.10.2003 të Këshillit Bashkiak Himarë", është vërtetuar me vendim të formës së prerë, konkretisht, vendimi nr. 495, datë 18.10.2012 i Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin janë deklaruar fajtor dhe janë dënuar shtetasit Jorgji Buta dhe Artan Llazari, lëshuesit e dokumentit, për veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve në bashkëpunim", parashikuar nga nenet 186/3 e 25 të Kodit Penal.

Në këto kushte, duke qenë i falsifikuar "Vendimi nr. 13, datë 31.10.2003. i Këshillit Bashkiak Himarë", për rjedhim të pestë Vendimet nr. 133, nr. 134, nr. 135, nr. 136, datë 29.05.2006; nr. 175, datë 21.06.2006, të K.V.K.K.P. Vlorë, si dhe Vendimi nr. 1333, datë 19. 05. 2008. i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë me përmbajtje të falsifikuar, të rreme, pasi derivojnë nga një dokument i falsifikuar.

Rezultoi se nga Prokuroria, hetimi i dokumentit të falsifikuar "Vendim nr. 13, datë 31.10.2003, i Këshillit Bashkiak Himarë" është kryer në kuadër të çështjes penale nr. 1003 të vitit 2008. Në këtë çështje penale, veç shtetasve Jorgji Butja e Artan Llazari, që janë deklaruar fajtor dhe për falsifikimin e këtij dokumenti, është hetuar edhe shtetasi Petro Beja për të cilin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 296, dt. 08.10.2009 ka vendosur ndryshimin e formulimit të vendimit të pushimit datë 08.05.2009 në ngarkim të shtetasit Petro Beja, duke arsyetuar se "nuk provohet që ky shtetas e ka kryer veprën penale." Në këtë gjykim, i pandehuri Petro Beja është përfaqësuar nga vëllai i tij, i pandehuri Theodhori Beja. Lidhur me këto vendime gjykate dhe deklarimin të falsifikuar të Vendimit me nr. 13, date 31.10.2003 të Këshillit Bashkiak Himarë, të tre të pandehurit kanë qenë në dijeni para kryerjes prej tyre të transaksioneve më vitet 2014 e 2015.

Këtë pretendim prokuroria e mbështet në provat si më poshtë:

Aktet shkresore të fashikullit të procedimit penal nr. 302 të vitit 2016 gjithësej 5 volume, të administruara në gjykim si pasojë e procedimit me gjykim të

shkurtuar.

Si përfundim, organi i akuzes pretendoi se të pandehurit Thoma Beja, Theodhori Beja, Petro Beja, me dashje të drejtëpërdrejtë, kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura dhe mbrojtura nga shteti për të garantuar fitimin, përdorimin, posedimin e pasurisë dhe ndalimin e fitimit, posedimit, përdorimit dhe kryerjes së transaksioneve me pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, pra që burojnë nga një vepër penale, në dëm të interesave të shtetit dhe shtetasve. Të pandehurit, duke qenë plotësisht në dijeni se pasuria me sipërfaqe totale 54.6 HA, e ndodhur në vendin Gjilekë - Dhermi, regjistruar fillimisht pranë Z.V.R.P.P. - Vlorë me nr. 440, 441, 442, 443, viti 2006 dhe nr. 207, viti 2008, mbi bazën e titujve të pronësisë me përmbajtje të rreme: "Vendime nr. 133, nr. 134, nr. 135, datë 29.05.2006 dhe nr. 175, datë 21.06.2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, si dhe Vendim nr. 1333, dt. 19. 05. 2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë", për shkak se janë marrë mbi bazën e dokumenteve ligjore që derivojnë nga dokumenti ligjor i falsifikuar me vlerë thelbësore ligjore për kthimin e pronës: "Vendimi nr. 13, datë 31.10.2003, i Këshillit Bashkiak Himarë", një pjesë të kësaj pasurie e kanë poseduar, përdorur, ndarë/pjestuar dhe shitur në vitet 2014 - 2015 - 2016, me qëllim fshehjen/mbulimin e origjinës së paligjshme, natyrën dhe burimin e vërtetë të saj, duke qenë të ndërgjegjshëm se kjo pasuri është produkt i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Nga shitja e kësaj pasurie, të pandehurit kanë përfituar financiarisht vlera të konsiderueshme financiare, të cilat i kanë integruar si burim të ligjshëm të të ardhurave të tyre.

Rezultoi e provuar se të pandehurit kanë patur plotësisht dijeni që nga viti 2009 (kur është përfunduar hetimi i procedimit penal nr. 1003 të vitit 2008 dhe shtetasit Petro Beja i janë pushuar hetimet për shkak se nuk provohet që e ka kryer veprën penale, për të cilën e ka përfaqësuar edhe në Gjykatë se pasuria e mësipërme nuk është përfituar në mënyrë të ligjshme, por mbi bazën e dokumentave të falsifikuara që kanë prodhuar tituj pronësie me përmbajtje të rreme/falsifikuar dhe regjistrim pasurie e dokumente pronësie me përmbajtje po të rreme si pasojë e efektit zinxhir që rrjedh nga fiktiviteti i një dokumenti. Më pas, këta të pandehur duke përdorur vërtetimet hipotekore të pasurive të ndara dhe regjistruara, të cilat gjithashtu janë me përmbajtje të rreme, pasi kanë prejardhje nga dokumente të falsifikuara, kanë tjetërsuar/transferuar tek persona të tjerë disa nga pasuritë e paluajtshme që janë produkt i veprës penale "falsifikimi i dokumentave" të parashikuar nga neni 186 e 25 i K.Penal, me qëllim fshehjen dhe mbulimin e origjinës së paligjshme të pasurisë, si dhe duke fshehur e mbuluar natyrën e vërtetë të burimit të saj.

Ndërsa i pandehuri Thoma Beja, perms mbrojtësit të tij av. Edmond Dema kërkoi deklarimin e tij të pafajshëm duke pretenduar se fakti në ngarkim të të pandehurve nuk përbën vepër penale. Veprimet e kryera prej të pandehurve janë ligjore dhe të rregullta pasi prona ka qenë e konfirmuar, e pangacmuar, e lire dhe aq më tepër që me tjetërsimet e saj nuk është synuar fshehja e pronësisë, pasi pjesa më e madhe e saj, ende sot është në emër të pronarëve të pandehur, por në kushtet e tregut janë kryer shitje vetëm kur janë gjetur blerës.



Për më tepër, edhe pse pasuritë e të pandehurit ishin kufizuar nga regjistruesi me urdhër të taks forces, mbi ankimin e të pandehurit Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë e ka hequr këtë kufizim me vendimin Nr. 482, dt. 14.04.2017, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

Prokuroria nuk arriti të provonte se transaksionet e realizuara me këto prona si pjestimi dhe shitja e një pjese, të jenë bërë për të fshehur origjinën e saj, dhe gjithashtu as të vërtetojë se të pandehurit kanë dijeni se ajo është produkt i veprës penale, sidomos i pandehuri Thoma Beja. Gjithashtu, i pandehuri nuk është subjekt i kësaj vepre penale pasi ai nuk është pronar i këtyre pasurive.

Gjithashtu, të pandehurit përfshirë të pandehurin Thoma Beja, nuk kanë përfituar në mënyrë të paligjshme prona. Sa i takon vendimit nr. 13, dt. 13.01.2003 të Këshillit Bashkiak Himarë i pandehuri Petro Beja nuk mund të hetohet për të njejtin fakt bazuar në nenin 7 të K.Pr.Penale. Prokuroria nuk provon se rrjedhojë e cilës veprimtari kriminale apo e cilës vepër penale është pasuria e pretenduar si produkt dhe as dijeninë e tyre mbi falsifikimin. Prona prej të pandehurve është fituar si rezultat i vendimmarrjes së organeve administrative dhe jo si rezultat i kryerjes së ndonjë vepre penale.

I pandehuri Theodhori Beja parashtrroi para Gjykatës se në rastin konkret ka vetëm një hamendësim nga organi i akuzës dhe asnjë provë për të provuar se ndonjëri prej të pandehurve e ka kryer veprën për të cilën akuzohen. I pandehuri ka përfituar si trashëgimtar i babait të tij pasuritë objekt gjykimi dhe i ka regjistruar ato në ZVRPP Vlorë Ky vendim është marrë nga organi kompetent shtetëror dhe jo nga të pandehurit ndaj duke qenë se ky vendim është i ligjshëm, dhe prona e përfituar është e ligjshme. Shitja e pasurisë nuk parashikohet si krim nga Kodi Penal. Në kushtet kur akuza nuk provohet i pandehuri duhet të deklarohet i pafajshëm.

Ndërsa i pandehuri Petro Beja, perms përfaqësuesit të tij av. Blerim Halluli pretendoi se konkluzioni i organit të akuzës se vendimet e KVKKP Vlorë janë marrë mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara është i pabazuar, pasi dhe dokumenti të cilin prokuroria e pretendon si të falsifikuar nuk i është deklaruar falsiteti dhe nuk është asgjësuar ndonjëherë. Për më tepër, në asnjë pjesë të vendimit të Gjykatës që përbën titullin e pronësisë nuk rezulton të përmendet ky dokument i pretenduar si i falsifikuar.

Së pari, megjithëse mund të ketë ekzistuar falsifikimi I këtij dokumenti, Gjykata asnjëherë nuk ka disponuar asgjësimin e tij ndaj ai do të vazhdojë të sjellë pasoja.

Së dyti, nga ana e të pandehurit Petro Beja nuk është kryer asnjë veprim që të çënojë marrëdhëniet juridike të mbrojtura me ligj pasi ndaj vendimit të këshillit nuk është marrë asnjë vendim për deklarimin e falsitetit dhe asgjësimin e tij, ndaj ai është sjellë si pronar me pronën e tij duke kryer transaksione të ligjshme.

Së treti të gjitha veprimet që pretendohen prej organit të akuzës të jenë bërë me qëllim fshehjen e origjinës janë të pavërteta dhe të pabazuara në prova.

Së katërti Prokuroria nuk provon shkakun/motivet e të pandehurit Petro Beja pasi ai në asnjë moment nuk ka pasur veprime keqdashëse, ai është sjellë si

pronar i ligjshëm.

I pandehuri akuzohet për një veprim për të cilin me vendim gjyqësor të forms së prerë është deklaruar se nuk ka dijeni, pra skemi veprime active kur është vërtetuar se ky i pandehur ska dijeni se dokumenti është i falsifikuar.

II. Qëndrimi i Gjykatës.

Gjykata vëren se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për siguruar rendin dhe sigurinë publike, sistemin monetar dhe financiar, interest e ligjshme të shtetit dhe të shtetasve, të mbrojtura posaçërsht nga legjislacioni penal. Cënimi i kësaj marrëdhënieje nga shtetasit përbën krim dhe passjell përgjegjësi penale.

-Në lidhje me akuzën.

E ndodhur përpara rrethanave dhe fakteve të çështjes objekt gjykimi dhe provave të administruara në gjykim, Gjykata çmon se veprimet e të pandehurve Theodhori Beja, Petro Beja dhe Thoma Beja, plotësojnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287/a,b,c i Kodit Penal.

Kjo dispozitë ligjore sanksionon:

"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transakcioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; - dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim . Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashikuar ose amnistuar; c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga

e cila kanë rrjedhur produktet; ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë; d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. **Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.**”.

Siç shihet qartë, neni 278 i K.Penal, i ndryshuar, është përshkrues për mënyrën sesi kryhet vepra penale. Duke u nisur nga teknika legislative rezulton se ky nen jep vetëm elementët e anës objektive nëpërmjet të cilave mund të realizohet vepra penale në fjalë, por në përmbajtjen e tij nuk jepet kuptimi i termave “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”

Gjykata vëren se, kuptimin e termit “produkte të veprës penale” e gjejmë në nenin 36/b të K.Penal i cili parashikon: “të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale”. Ky parashikim është i ngjashëm me atë të nenit 1 të Konventës së Këshillit të Europës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për Financimin e Terrorizmit”, e thënë ndryshe Konventa e Varshavës, e ratifikuar nga vendi ynë dhe që përbën instrument të detyrueshëm ligjor. Sipas kësaj konvente termi “produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale, i cili mund të konsistojë në çdo pasuri që sipas paragrafit b të po të njejtit nen mund të jetë e çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme si dhe aktet juridike dhe dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri.

Termi ndërkombtar me të cilin njihet procesi i pastrimit të parave ose produkteve kriminale është “money laundering”, i cili nënkupton aktin e transferimit të parave të përfituara në mënyrë të paligjshme nëpërmjet njerëzve apo llogarive të ligjshme në mënyrë që të mos ketë mundësi të gjendet apo arrihet burimi i tyre, pra fshihet burimi i paligjshëm.

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale është një krim i pavarur, i parashikuar si i tillë nga vetë legjislatori. Pavarësisht kësaj, ajo nënkupton dy element thelbësor:

Së pari: Kryerjen e një vepre penale të mëparëshme, vepër penale “mëmë” nga ana e një subjekti të përgjithshëm ose të posaçëm, e cila është e parashikuar si e tillë nga legjislacioni penal dhe e dënueshme. Kjo vepër, sipas legjislacionit tone, nuk ka rëndësi nëse është krim apo kundravajtje.

Së dyti: Kryerjen e një sër veprimesh të tjera, ose nga i njejt person që ka kryer krimin “mëmë”, ose ndërhyrja e një ose disa personave të tjerë për t'i

dhënë asaj pasurie të grumbulluar në mënyrë kriminale, një dukje legjitime. Personat që ndërhyjnë duhet ta dinë origjinën e paligjshme dhe kriminale të pasurisë dhe me vetëdije marrin hapa për t'i trajtuar këto produkte nëpërmjet mekanizmave kompleks.

Ekzistenca e kësaj vepre penale "mëmë" kërkohet vetëm për të përcaktuar përfitimin e ardhur, pasurinë e shtuar në mënyrë të paligjshme, por dënimi për të nuk është parakusht për ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, përkundrazi, është pikërisht mosparashikimi i një dënimi të mëparshëm, ai që është kusht i caktuar nga neni 9, paragr 5 i Konventës së Varshavës, i cili shprehimisht parashikon: "Çdo palë do të sigurojë që një dënim i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprën penale kryesore nuk është parakusht për një dënim për pastrim parash". Këtë element Gjykata e thekson në kuadër të pretendimeve të pandehurve se ata nuk janë dënuar ndonjëherë për ndonjë vepër penale e as për atë të "Falsifikimit të dokumentave". Ky fakt, nuk përbën shkak për përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale për kryerjen e veprës penale për të cilën janë akuzuar, bazuar në nenin 9/5 të Konventës së Varshavës, e ratifikuar nga shteti ynë dhe që sipas kushtetutës ka epërsi mbi ligjet e vendit, e çdo dispozitë e brendshme duhet interpretuar në frymën e saj.

Objekt i veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal janë marrëdhëniet juridike të vendosura që synojnë funksionimin normal të sistemit ekonomik e financiar, pastërtinë e tij, luftën kundër krimeve në përgjithësi. E parashikuar në seksionin e veprave kundër rendit dhe sigurisë publike, pavarësisht se kjo vepër penale ka si objekt të saj paratë ose produktet e tjera që kanë një vlerë ekonomike të caktuar, pasojat e saj ndikojnë në një numër të madh personash krahasuar me ata të cilët janë zhveshur padrejtësisht nga kjo pasuri.

Objekti material i kësaj vepre penale janë paratë, të mirat ose të tjera dobi, përfshihen dhe pasuritë e paluajtshme dhe përfitimet monetare në këmbim të tyre siç rezulton edhe në rastin objekt gjykimi, ku product I veprës penale rezulton të jenë pasuri të paluajtshme pyll dhe kullotë 54.6 HA në emër të Petro, Milo dhe Theodhori Beja.

Nga pikëpamja e **anës objektive**, kjo vepër mund të realizohet me një veprim të vetëm ose me shumë veprime të lidhura ndërmjet tyre, që kalojnë në disa faza dhe që zhvillohen në kohë. Vetë neni 287 i K.Penal nënkupton disa figura të veprës penale duke u nisur nga mënyra dhe mjetet me anë të të cilave ajo realizohet.

Përsa i përket anës objektive për ta konsideruar të konsumuar këtë vepër penale, duhet të evidentohen në mënyrë cumulative këta element:

1. Të ekzistojë veprimi, në format e përshkruara nga dispozita, në gërmat a deri dh të saj, si këmbim ose transferim të pasurisë, fshehjen, mbulimin e natyrës së vërtetë të burimit, zhvendosjes pronësisë, fitimit, vendosjen së posedimit ose përdorimit, kryerjen e veprimeve transaksioneve, shitje, blerje etj;

dhënë asaj pasurie të grumbulluar në mënyrë kriminale, një dukje legjitime. Personat që ndërhyjnë duhet ta dinë origjinën e paligjshme dhe kriminale të pasurisë dhe me vetëdije marrin hapa për t'i trajtuar këto produkte nëpërmjet mekanizmave kompleks.

Ekzistenca e kësaj vepre penale "mëmë" kërkohet vetëm për të përcaktuar përfitimin e ardhur, pasurinë e shtuar në mënyrë të paligjshme, por dënimi për të nuk është parakusht për ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, përkundrazi, është pikërisht mosparashikimi i një dënimi të mëparshëm, ai që është kusht i caktuar nga neni 9, paragr 5 i Konventës së Varshavës, i cili shprehimisht parashikon: "Çdo palë do të sigurojë që një dënim i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprën penale kryesore nuk është parakusht për një dënim për pastrim parash". Këtë element Gjykata e thekson në kuadër të pretendimeve të të pandehurve se ata nuk janë dënuar ndonjëherë për ndonjë vepër penale e as për atë të "Falsifikimit të dokumentave". Ky fakt, nuk përbën shkak për përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale për kryerjen e veprës penale për të cilën janë akuzuar, bazuar në nenin 9/5 të Konventës së Varshavës, e ratifikuar nga shteti ynë dhe që sipas kushtetutës ka epërsi mbi ligjet e vendit, e çdo dispozitë e brendshme duhet interpretuar në frymën e saj.

Objekt i veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal janë marrëdhëniet juridike të vendosura që synojnë funksionimin normal të sistemit ekonomik e financiar, pastërtinë e tij, luftën kundër krimeve në përgjithësi. E parashikuar në seksionin e veprave kundër rendit dhe sigurisë publike, pavarësisht se kjo vepër penale ka si objekt të saj paratë ose produktet e tjera që kanë një vlerë ekonomike të caktuar, pasojat e saj ndikojnë në një numër të madh personash krahasuar me ata të cilët janë zhveshur padrejtësisht nga kjo pasuri.

Objekti material i kësaj vepre penale janë paratë, të mirat ose të tjera dobi, përfshihen dhe pasuritë e paluajtshme dhe përfitimet monetare në këmbim të tyre siç rezulton edhe në rastin objekt gjykimi, ku product I veprës penale rezulton të jenë pasuri të paluajtshme pyll dhe kullotë 54.6 HA në emër të Petro, Milo dhe Theodhori Beja.

Nga pikëpamja e **anës objektive**, kjo vepër mund të realizohet me një veprim të vetëm ose me shumë veprime të lidhura ndërmjet tyre, që kalojnë në disa faza dhe që zhvillohen në kohë. Vetë neni 287 i K.Penal nënkupton disa figura të veprës penale duke u nisur nga mënyra dhe mjetet me anë të të cilave ajo realizohet.

Përsa i përket anës objektive për ta konsideruar të konsumuar këtë vepër penale, duhet të evidentohen në mënyrë cumulative këta element:

1. Të ekzistojë veprimi, në format e përshkruara nga dispozita, në gërmat a deri dh të saj, si këmbim ose transferim të pasurisë, fshehjen, mbulimin e natyrës së vërtetë të burimit, zhvendosjes pronësisë, fitimit, vendosjen së posedimit ose përdorimit, kryerjen e veprimeve transaksioneve, shitje, blerje etj;

2. Pasuria mbi të cilën veprohet të jetë produkt i një veprë penale ose veprimtarie kriminale;

3. Të ekzistojë dijenia e subjektit se kjo pasuri është produkt i një veprë penale. Pra, kryerësi e di që prona ose pasuria nuk është e ligjshme por rrjedh nga vepra penale. Në këtë kuadër Gjykata çmon të theksojë se mund të gjendemi para dy rasteve, rasti i parë kur kjo veprë kryhet nga vetë personi që ka kryer veprën "meme" siç parashikohet në pikën "c" të paragrafit të tretë të nenit 287 të K.Penal dhe rasti i dytë kur vepra e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale kryhet jo nga ai që ka kryer veprën penale "meme" por nga një person tjetër, siç është edhe rasti object gjykimi. Në këtë rast të dytë provueshmëria e dijenisë së autorit është më e vështirë, megjithatë ajo realizohet në rast se sipas rrethanave personi kishte mundësi dhe duhet ta kishte ditur.

4. Veprimet kryhen me dashje dhe me qëllim fshehjen e origjinës së pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Këtë element e parashikon neni 287 i K.Penal në fjalinë e fundit të tij dhe përbën anën subjektive të kësaj veprë. Dashja nënkupton se kryerësi i ka marr veprimet me dëshirë, vullnet dhe ndergjegje që pasuria të dukej e ligjshme.

Duke i analizuar këto element në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes object gjykimi, Gjykata çmon se këto element rezultuar në veprimet e kryera prej secilit prej tre të pandehurve.

Kështu, **së pari** u provua në gjykim se ekziston vepra penale "meme", e pikërisht ajo e "Falsifikimit të dokumentave", e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga K.Penal si krim në nenin 186/3-25 të tij për të cilën janë deklaruar fajtor me vendimin Nr. 495, datë 18.10.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë, shtetasit Jorgji Buta dhe Artan Llazari.

Gjykata rithekson edhe një herë se ekzistenca e veprës penale "meme" kërkohet si kusht vetëm për ekekt të përcaktimit të përfitimit të paligjshëm, i cili në rastin konkret janë pikërisht pasuritë e evidentuara nga organi i akuzës dhe për të cilat është vendosur sekuestro. Për këtë, nuk ka rëndësi në është dënuar apo jo ndonjëri nga të pandehurit, kjo sipas detyrimeve që i janë vendosur shtetit tonë në nenin 9/5 të Konventës së Varshavës, i sipërcituar dhe përmbajtjes së nenit 287 të K.Penal. Pra vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit mbështetet thjesht në ekzistencën e një pasurie që vjen nga një veprë penale, pasuri që dikush që e di nga vjen i mer dhe i transformon duke i fshehur origjinën e paligjshme. E vetmja lidhje me veprën "meme", në këtë rast pra është ekzistenca e produktit kriminal dhe jo fakti nëse subjekti mban përgjegjësi dhe për atë veprë apo jo.

Së dyti: Rezultoi se sipërfaqja e tokës, pasuria e paluajtshme pyll dhe kullotë 54.6 HA, e transformuar sot në pasuritë e evidentuara dhe të sekuestruara nga organi i akuzës, është përfituar prej të pandehurve Theodhori Beja, Petro Beja dhe Thoma Beja nëpërmjet falsifikimit të dokumentave, duke përfaqësuar

produktin kriminal. Pro kjo pasuri nuk është fituar nga të pandehurit me mënyra origjinale të fitimit të pronësisë sipas Kodit Civil. Ndryshe nga çkanë pretenduar ata se kjo pasuri është fituar me anë të trashëgimisë nga trashëgimlënësit e tyre, të ndjerët Thoma dhe Fotina Bejo, Gjykata vëren se titulli i tyre i parë i pronësisë, nga kanë rrjedhur dhe si pasojë e të cilit janë kryer të gjitha veprimet e mëpasshme, drejtimi pranë KVKKP Vlorë, çeljet e dëshmimeve të trashëgimisë, drejtimi Gjykatës apo ZVRPP Vlorë, është pikërisht vendimi nr. 13, dt. 31.10.2003 i Këshillit Bashkiak Himarë, i cili është i falsifikuar.

Të pandehurit, e kanë regjistruar këtë pasuri mbi bazën e dokumentave të falsifikuara pasi kjo pronë është shtet dhe nuk ka qenë kurrë e tyrja apo e trashëgimlënësve të tyre.

Së treti, të pandehurit kanë kryer veprime të shumëllojshme si fitim i pronësisë duke iu drejtuar me një dokument të falsifikuar KVKKP Vlorë, e kanë regjistruar, pjestuar, tjetërsuar, shitur. Sipas Kodit Civil pronësia fitohet vetëm me shkak të ligjshëm, ky shkak i ligjshëm i jep të drejtë individit të gëzojë, posedojë dhe disponojë mbi të. Pretendimi I të pandehurit Petro Beja se ai ka ushtruar tagrat e pronarit të ligjshëm mbi pasuritë e tij është totalisht i pabazuar në ligj, sjellje si pronar i ligjshëm nuk mund të konsiderohet ushtrimi i tagrave të pronarit mbi një pasuri të fituar në mënyrë të paligjshme. Fakti se veprimet e mëvonshme mund të jenë kryer conform apo jo ligjit nuk rekuperon e as shëron përfitimin e paligjshëm të saj. Nëse do të bënim një interpretim a contrario të nenit 287 të K.Penal, atëherë do të pranohet që të pandehurit të cilët kanë shtuar pasurinë e tyre në mënyrë të paligjshme, tashmë ta ligjëronin pas regjistrimit, pjestimit apo rishitjes, pra do të pranohet pikërisht atë fenomen që synon të godasë kjo dispozitë.

Pra, qartazi u provua fakti se dhe pse nuk janë ata kryerësit e veprës penale "mëmë", në këtë rast "Falsifikimit të dokumentave", të pandehurit Theodhori Beja, Petro Beja dhe Thoma Beja, kanë ndërhyrë duke e transferuar, transformuar, duke i dhënë dukje të ligjshme me një sërë veprimesh si, regjistrim, pjestim, shitje, tjetërsim.

Së katërti: Si me të drejtë u pretendua prej organit të akuzës, të tre të pandehurit kanë patur dijeni të plotë në lidhje me burimin e paligjshëm të kësaj pasurie, element ky, i cili rezulton, ashtu siç e parashikon vetë neni 287 i K.Penal në paragrafin e fundit të tij, nga të gjitha rrethanat objektive. Të pandehurit nuk kishin si të mos dinin se kjo pasuri nuk ishte e tyrja përse kohë që ende edhe sot evidentohen nga akrimi shtetëror zyra pranë Këshillit të Qarkut Vlorë se ku dhe cilat janë pasuritë e tyre e ku pasuritë object gjykimi rezultojnë qartazi se nuk bëjnë pjesë, këto pasuri nuk kanë qenë ndonjëherë të trashëgimlënësve të tyre ndaj skishin si të bëheshin të të pandehurve, për më tepër lidhur me falsifikimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë, të pandehurit rezulton të jenë vënë në dijeni që në kohën që ky fakt ka qenë object procedimi penal për të cilin ka qenë duke u hetuar edhe vetë I pandehuri Petro Bejo, e gjykim në të cilin është përfaqësuar edhe prej të vëllait Theodhori

Bejo. Neglizhenca me dashje e të pandehurve për të marrë dijëni barazohet me dijeninë dhe nuk mund të përbëjë shkak për perjashtim nga përgjegjsia penale.

Subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal mund të jetë si i përgjithshëm ashtu edhe i posaçëm, dhe të tre të pandehurit i gëzojnë cilësitë për t'u konsideruar të tillë pasi ata e kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, e konkretisht, i pandehuri Petro Beja është 80 vjeç (i dtl. 1937), i pandehuri Theodhori Beja është 76 vjeç (i dtl. 1941) dhe i pandehuri Thoma Beja është 54 vjeç (i dtl. 1963) dhe janë të përgjegjshëm.

Edhe njëherë në kuadër të pretendimeve të ngritura prej të pandehurve, Gjykata thekson se subjekt i kësaj vepre penale është edhe personi që nuk e ka kryer vetë veprën penale "mëmë" pra atë nga e cila ka ardhur produkti i paligjshëm,, por që kryen veprime që synojnë pastrimin e produkteve të rrjedhura nga ajo vepër. Konventat e ndryshme ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë vendosin për shtetin detyrimin e kriminalizimit të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe këto konventa nuk e lidhin përgjegjësinë e subjektit me kryerjen prej tij të veprës bazë.

Nga ana subjektive siç ka analizuar më lart kjo gjykatë kjo vepër kryhet me dashje siç rezulton të kenë vepruar edhe të pandehurit në rastin konkret, të cilët, siç me të drejtë u pretendua prej organit të akuzës, se të pandehurit Thoma Beja, Theodhori Beja, Petro Beja, me dashje të drejtëpërdrejtë, kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura dhe mbrojtura nga shteti për të garantuar fitimin, përdorimin, posedimin e pasurisë dhe ndalimin e fitimit, posedimit, përdorimit dhe kryerjes së transaksioneve me pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, pra që burojnë nga një vepër penale, në dëm të interesave të shtetit dhe shtetasve. Të pandehurit, duke qenë plotësisht në dijeni se pasuria me sipërfaqe totale 54.6 HA, e ndodhur në vendin Gjilekë - Dhermi, regjistruar fillimisht pranë Z.V.R.P.P. - Vlorë me nr. 440, 441, 442, 443, viti 2006 dhe nr. 207, viti 2008, mbi bazën e titujve të pronësisë me përmbajtje të rreme: "Vendime nr. 133, nr. 134, nr. 135, datë 29.05.2006 dhe nr. 175, datë 21.06.2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, si dhe Vendim nr. 1333, dt. 19. 05. 2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë", për shkak se janë marrë mbi bazën e dokumenteve ligjore që derivojnë nga dokumenti ligjor i falsifikuar me vlerë thelbësore ligjore për kthimin e pronës: "Vendimi nr. 13, datë 31.10.2003, i Këshillit Bashkiak Himarë", një pjesë të kësaj pasurie e kanë poseduar, përdorur, ndarë/pjestuar dhe shitur në vitet 2014 - 2015 - 2016, me qëllim fshehjen/mbulimin e origjinës së paligjshme, natyrën dhe burimin e vërtetë të saj, duke qenë të ndërgjegjshëm se kjo pasuri është produkt i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Nga shitja e kësaj pasurie, të pandehurit kanë përfutur financiarisht vlera të konsiderueshme financiare, të cilat i kanë integruar si burim të ligjshëm të të ardhurave të tyre.

Rezultoi e provuar se të pandehurit kanë patur plotësisht dijeni që nga viti 2009 (kur është përfunduar hetimi i procedimit penal nr. 1003 të vitit 2008 dhe shtetasit Petro Beja i janë pushuar hetimet për shkak se nuk provohet që e

ka kryer veprën penale, për të cilën e ka përfaqësuar edhe në Gjykatë se pasuria e mësipërme nuk është përfituar në mënyrë të ligjshme, por mbi bazën e dokumentave të falsifikuara që kanë prodhuar tituj pronësie me përmbajtje të rreme/falsifikuar dhe regjistrim pasurie e dokumente pronësie me përmbajtje po të rreme si pasojë e efektit zinxhir që rrjedh nga fiktiviteti i një dokumenti. Më pas, këta të pandehur duke përdorur vërtetimet hipotekore të pasurive të ndara dhe regjistruara, të cilat gjithashtu janë me përmbajtje të rreme, pasi kanë prejardhje nga dokumente të falsifikuara, kanë tjetërsuar/transferuar tek persona të tjerë disa nga pasuritë e paluajtshme që janë produkt i veprës penale "falsifikimi i dokumentave" të parashikuar nga neni 186 e 25 i K.Penal, me qëllim fshehjen dhe mbulimin e origjinës së paligjshme të pasurisë, si dhe duke fshehur e mbuluar natyrën e vërtetë të burimit të saj.

Bazuar në sa është analizuar më lart Gjykata çmon se veprimet e të pandehurve janë cilësuar drejtë prej organit të akuzës ndaj secili prej tyre duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal.

Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit.

Në lidhje me dënimin e të pandehurve Theodhori Beja, Petro Beja dhe Thoma Beja, gjykata vëren se, lloji i dënimit për veprën penale të kryer prej tyre përcaktohet nga vetë ligji, neni 287 i K.Penal i cili parashikon: "...dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.". Kjo dispozitë, siç shihet, ka përcaktuar një lloj dënimi, atë me burgim.

Për sa i përket masës së dënimit, gjykata mban parasysh:

1. Rrezikshmërinë e veprës penale të kryer nga të pandehurit dhe të pasojës së saj. Në këtë kuadër gjykata vëren se vepra penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" është parashikuar në K.Penal si krim dhe jo si kundravajtje, gjë që tregon çmimin që legjislatori i ka bërë rrezikshmërisë së kësaj vepre. Gjithashtu, gjykata mban parasysh marrëdhëniet juridike që kjo vepër prek ose cënon, si dhe faktin që kjo vepër dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet, marzhe këto relativisht të larta të cilët shfaqin dhe politikën penale të ligjvënësit në këtë rast si dhe pasojat që kjo vepër sjell.
2. Rrezikshmërinë e autorit, e konkretisht, të tre të pandehurit rezultuan me gjendje gjyqësore të padënuar dhe rrethanat që lidhen me gjendjen sociale e shoqërore të tyre, janë të martuar, moshën e tyre, konkretisht i pandehuri Petro Bejo është 80 vjeç, i pandehuri Theodhori Bejo është 76 vjeç dhe i pandehuri Thoma Bejo është 54 vjeç.
3. Rrethanat lehtësuese. Bazuar në nenin 49 të K.Penal, gjykata çmon si rrethanë lehtësuese faktin se të pandehurit nuk janë përsëritës, por nga ana tjetër gjykata mban parasysh dhe faktin se asnjëri prej tyre nuk e ka pranuar fajësinë dhe as nuk ka shfaqur pendim.
4. Formën e fajit, të tre të pandehurit e kanë kryer veprën me dashje direkte.

Në analizë të sa më sipër, gjykata çmon se dënimi i kërkuar nga Prokuroria

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për tu caktuar ndaj secilit prej të pandehurve është i drejtë dhe në përputhje me rrethanat e çështjes dhe qëllimin riedukues e parandalues (të posaçëm e të përgjithshëm) të dënimit penal. Në lidhje me dënimin ndaj të pandehurit Thoma Beja, Gjykata e konstaton të drejtë kërkesën e organit të akuzës për masën e dënimit në minimumin e parashikuar nga dispozita, kjo duke patur parasysh rolin dhe veprimet e kryera prej tij, të cilat shfaqin rrezikshmëri më të ulët shoqërore se dy të pandehurit e tjerë.

Duke qenë se për gjykimin e kësaj çështjeje, mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga të pandehurit, u procedua me gjykim të shkurtuar, në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të tre të pandehurve do tu ulet e 1/3 së dënimit.

Gjykata, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e pakët të të pandehurve, faktin se janë të martuar dhe kryefamiljar dhe moshën e tyre, në zbatim të nenit 59 të K.Penal vendosi të pezullojë ekzekutimin e vendimit me burgim dhe vënien e të pandehurve Theodhori Beja, Petro Beja dhe Thoma Beja në provë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh me kusht që bazuar në nenin 61 të K.Penal ata të mbajnë kontakte me shërbimin e provës dhe gjatë kësaj periudhe të mos kryejnë veprë tjetër penale pasi çmon se plotsohen kushtet e aplikimit të kësaj dispozite duke ju referuar moshës relativisht të madhe të të pandehurve, rrezikshmërinë e tyre të ulët shoqërore si persona të padënuar më parë si dhe në tërësi rrethanat e kryerjes së veprës.

Gjykata vëren se neni 59/2 i K.Penal parashikon: *"Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi."*, ndërsa neni 60 i po këtij Kodi parashikon: *"I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtëme."* dhe më poshtë: *"...Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivin e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikqyrjen e tyre."*

Në analizë logjike dhe sistematike të këtyre dy dispozitave, si dhe duke i interpretuar ato në përputhje me qëllimin e dënimit penal, gjykata vëren se vendosja e njërit apo disa prej detyrimeve të parashikuara nga neni 60 i K.Penal është në diskrecion të gjykatës, e cila rast pas rasti duhet të vlerësojë se cili prej tyre do të ishte më i përshtatshëm për riedukimin e personit, parandalimin e përgjithshëm e të posaçëm, duke marrë parasysh, ashtu siç shprehet vetë neni 60 rrethanat që lidhen me autorin e veprës, gjendjen e tij sociale, ekonomike dhe shkaqet e kryerjes së veprës. Në këto kushte, nuk do të kishte kuptim caktimi i njërit ose disa prej detyrimeve të parashikuara nga ky nen në rast se ai/ato nuk do të përputheshin me rrethanat e çdo çështje konkrete.

Bazuar në këtë arsytim, gjykata çmon të papërshtatshme të caktojë ndonjë prej detyrimeve të parashikuara nga neni 60 i K.Penal për të pandehurit.

Po kështu, bazuar në nenin 190 të K.Pr.Penale Gjykata çmon të deklarojë të falsifikuar dokumentacionin e sekuestruar si provë materiale me procesverbalet e datës 12.07.2016; 15.09.2016, 19.09.2016 pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe me të urdhërojë asgjësimin e tij.

Për sa i përket pasurive të sekuestruara, e konkretisht, pasuria e paluajtshme e vendosur nën masën e sigurimit pasuror "sekuestro preventive" me vendimin me nr. 249, dt. 15.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e llojit "Kullotë", "Pyll", me sipërfaqe totale prej 54.6 hektarë, e ndodhur në fshatin Gjilekë-Dhërmi, regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me numrat hipotekorë 440, 441, 442 dhe 443 datë 20.12.2006 dhe nr. 207 datë 31.07.2008, që kanë pasur si titull pronësie vendimet me nr. 133, nr. 134, nr. 135, nr. 136 datë 20.05.2006 dhe nr. 175 datë 21.06.2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarkut Vlorë dhe vendimit me nr. 1333 datë 19.05.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të konfiskohet dhe të kaloj në favor të shtetit bazuar në nenin 190 të K.Pr.Penale.

Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore ato i ngarkohen të pandehurve solidarisht, pasi atyre i referohet dënimi në zbatim të nenit 393/1 të K.Pr.Penale

Për këto arsye, gjykata, bazuar në nenet 190/1/b, 378, 406, 485 të K.Pr.Penale si dhe nenet 48, 49, 287/a/b/c të K.Penal;

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Petro Beja, për kryerjen e veprës penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.
2. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen me 1/3 e dënimit.
3. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 5-vjetësh.
4. Urdhërohet i pa ndehuri Petro Beja të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të njoftojë shërbimin e provës për ndryshimin e vendbanimit dhe lëvizjet e tij brenda vendit
5. Deklarimin fajtor të të pandehurit Theodhori Beja, për kryerjen e veprës penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.
6. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen me 1/3 e dënimit.
7. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 5-vjetësh.

8. Urdhërohet i pandehuri Theodhori Beja të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të njoftojë shërbimin e provës për ndryshimin e vendbanimit dhe lëvizjet e shpeshta brenda vendit.
9. Deklarimin fajtor të të pandehurit Thoma Beja, për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 gërmat (a), (b) dhe (c) të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.
10. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen me 1/3 e dënimit.
11. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit për një periudhë prej 5-vjetësh.
12. Urdhërohet i pandehuri Thoma Beja të mbajë kontakte të rregullta me shërbimin e provës dhe të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për lëvizjet e shpeshta brenda vendit.
13. Deklarimin të falsifikuar të dokumentacionit të sekuestruar si provë materiale me procesverbalet e datës 12.07.2016; 15.09.2016, 19.09.2016 pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe me pas të asgjësohet ky dokumentacion.
14. Pasuria e paluajtshme e vendosur nën masën e sigurimit pasuror "sekuestro preventive" me vendimin me nr. 249, datë 15.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e llojit "Kullotë", "Pyll", me sipërfaqe totale prej 54.6 hektarë, e ndodhur në fshatin Gjilekë-Dhërmi, regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, me numrat hipotekor 440, 441, 442 dhe 443, datë 20.12.2006 dhe nr. 207 datë 31.07.2008, që kanë pasur si titull pronësie vendimet me nr. 133, nr. 134, nr. 135, nr. 136 datë 20.05.2006 dhe nr.175 datë 21.06.2006 të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarkut Vlorë dhe vendimin me nr. 1333, datë 19.05.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.
15. Shpenzimet procedurale të fazës së hetimit dhe ato të gjyqimit i'u ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare.
16. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall në Vlorë, sot më datë 04.10.2017

GJYQTAR
LAURENT FUÇIA

GJYQTARE
ATALANTA ZEQIRAJ

GJYQTAR
SKËNDER HALUCI

SEKRETARE
EGLANTINA MURATI



SHPENZIMET GJYQËSORE

Shpenzime gjate hetimeve paraprake	15.000	Lekë
Shpenzime kancelarie	4.000	Lekë
Shpenzime totale	19.000	Lekë

**SEKRETARE
EGLANTINA MURATI**



Vendimi mori forme te prere me vendimin nr.614 date 22.11.2018 te Gjykates se Apelit Vlore, e cila ka vendosur:

- Prishjen e vendimit nr. 564(61-2017-4424) dt 04.10.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe pushimin e ceshtjes penale ne ngarkimin e te pandehurit Thoma Beja.
- Lenien ne fuqi te vendimit te mepsiperm per pjesen tjeter.
- Shpenzimet proceduriaole per te pandehurin Thoma Beja i ngarkohen solidarisht dy te pandehurve Petro dhe Thoeodhori Beja .

Vlore me 15.02.2019

KRYESEKRETARE

Esmeralda NGUCAJ

